



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 229, datë 12.11.2019

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË LIDHUR ME VLERËSIMIN DHE
RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRGJITHSHËM**

Në zbatim të neneve 5,6,7,8,9 të rregullores me objekt “Rregullore mbi Kriteret dhe Procedurën për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenin 159, pika 1, gërma (gj) të ligjit “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETAR

GENT IBRAHIMI



Metodologjia Orientuese për Vlerësimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm¹

Hyrje

Kjo Metodologji është një dokument i brendshëm pune i Këshillit që synon të orientojë anëtarët e Këshillit në vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë bëhet duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuara në pikën 3, të nenit 148/a të Kushtetutës, në nenet 23 – 27 të Ligjit Nr. 97/2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në nenet 5 – 9 të Vendimit Nr. 50, datë 19.03.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Rregullore mbi Kriteret dhe Procedurën për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë".

Bazuar në urdhërimet e sipërpërmendura, kandidatët për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë do të vlerësohen dhe pikëzohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për sa më poshtë:

- **Aftësia profesionale:**

- (i) përvoja e punës (deri në 5 pikë);
- (ii) rezultatet e arritura në punë (deri në 5 pikë);
- (iii) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta dhe profesionale (deri në 3 pikë);
- (iv) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare (deri në 3 pikë), dhe
- (v) rezultatet e arritura në punën kërkimore shkencore (deri në 4 pikë);

- **Integriteti moral:**

- (i) reputacioni profesional (deri në 2 pikë) dhe
- (ii) reputacioni shoqëror (deri në 2 pikë);

- **Aftësia organizative dhe drejtuese:**

- (i) cilësia e platformës/vizionit, deri në 5 pikë;
- (ii) aftësia vendimmarrëse, deri në 5 pikë;
- (iii) aftësia në komunikim, deri në 4 pikë; dhe
- (iv) aftësia për të punuar në grup, deri në 3 pikë;
- (v) aftësia në përfaqësim publik, deri në 3 pikë);

- **Elementë shtesë si**

¹ Duhet miratuar me vendim të Këshillit dhe të botohet në Fletoren Zyrtare.

- (i) mbajtja e titujve akademikë (deri në 2 pikë);
- (ii) studimet dhe trainimet afatgjata jashtë vendit (deri në 2 pikë); dhe
- (iii) zotërimi i gjuhëve të huaja (deri në 2 pikë).

Kjo Metodologji rekomandon zberthimin e kuptimit të secilit kriter e nënkriter për të mundësuar një gjykim objektiv nga ana e anëtarëve të Këshillit në lidhje me shkallët e ndryshme të plotësimit të secilit nënkriter nga kandidatët.

Kriteri 1: Aftësia Profesionale - deri në 20 pikë

Nënkriteri 1.1: Kohëzgjatja dhe rëndësia e përvojës së punës - (1 - 5 pikë)

Nënkriteri 1.1 shërben për të matur 2 gjëra:

- a) kohëzgjatjen e përvojës profesionale të kandidatit; dhe
- b) rëndësinë/relevancën e përvojës së punës së kandidatit me natyrën e punës së Prokurorit të Përgjithshëm.

Për këtë nënkriter kandidati mund të vlerësohet me 1 – 5 pikë.

Bazuar në nenin 38 të Ligjit Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (i cili numëron kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm) rezulton se kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm mund të kategorizohen në 3 grupe:

- a) administrative/menaxheriale (neni 38/2/b/c/dh/e/f/g/h/dhe j);
- b) financiare/buxhetore (neni 38/2/ç dhe f);
- c) përfaqësimi (neni 38/2/a/d/ë/gj/i).

Në këto kushte, anëtarët e Këshillit orientohen që të kërkojnë dhe vlerësojnë ato përvoja profesionale të kandidatëve që përkojnë me 3 grupet e kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm të identifikuar më lart.

Nënkriteri 1.2: Rezultatet e arritura nga kandidati gjatë përvojës së punës - (1 - 5 pikë)

Nënkriteri 1.2 shërben për të matur cilësinë e punëve që ka bërë kandidati në të shkuarën. Me fjalë të tjera, vlerësimi i këtij nënkriteri do t'i japi mundësi anëtarit të Këshillit të gjykojë se sa i suksesshëm ka qenë kandidati në kryerjen e detyrave/punëve që ka pasur në të shkuarën.

Për vlerësimin e këtij nënkriteri, anëari i Këshillit mund të bazohet në 3 kategori informacionesh:

- a) dokumentat e paraqitura nga kandidatët;
- b) fakte/informacione rreth kandidatëve të ditura botërisht;dhe

c) informacionet e siguruar gjatë intervistës.

Dokumenta të cilat mund të ndihmojnë vlerësuesin (anëtarin e Këshillit) në vlerësimin e këtij nënkriteri mund të jenë akte të vlerësimit profesional të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, rekomandime apo çertifikata që vërtetojnë shkallë të lartë performance në punët/detyrat e kryera në të shkuarën ose dokumente/dëshmi (të paraqitura nga kandidatët ose të ditura botërisht) që vërtetojnë arritje të spikatura profesionale të kandidatit në të shkuarën (psh pjesëmarrje në grupe pune për hartimin e legjislacionit, në procese për ngritjen e institucioneve, në projekte të asistencës ndërkombëtare dhe në projekte të tjera, në forume ekspertësh brenda dhe jashtë vendit etj).

Nënkriteri 1.3: Rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta dhe profesionale - (1 - 3 pikë)

Nënkriteri 1.3 shërben për të matur rezultatet e arritura nga kandidatët gjatë studimeve të larta në drejtësi (diplomë e nivelit të dytë apo e ekuivalentuar me të, brenda dhe jashtë vendit) dhe gjatë studimeve profesionale në Shkollën e Magjistraturës (për kandidatët magjistratë).

Për caktimin e pikëve lidhur me këtë nënkriter vlerësimi, anëtari i Këshillit i referohet 2 (dy) burimeve të të dhënave:

- (i) Listës së notave gjatë studimeve universitare në drejtësi dhe listës së notave gjatë trainimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (kjo e dyta vetëm për kandidatët magjistratë);
- (ii) Listës së çertifikatave/vërtetimeve për pjesëmarrje në kurse/programe trainimi të zhvilluara në kuadër të trainimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës ose trainime të tjera.

Anëtari i Këshillit orientohet në caktimin e pikëve për këtë nënkriter, për secilin kandidat bazuar në këto burime të dhënash.

Duke qenë së shtete të ndryshme përdorin sisteme të ndryshme të vlerësimit të performancës së studentëve, për nxjerrjen e notës mesatare të barazvlefshme me 8, 8 – 9, ose mbi 9, anëtari i Këshillit mund të pjesëtojë rezultatin e arritur nga kandidati në shkollën e huaj me notën maksimale të përcaktuar nga sistemi përkatës. Për orientim të mëtejshëm mund të shërbejnë tabelat ndërkombëtare të konvertimit të rezultateve të arsimimit.

Nënkriteri 1.4: Rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në të drejtën penale ose menaxheriale - (1 - 3 pikë)

Nënkriteri 1.4 shërben për të matur rezultatet e arritura nga kandidatët gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale ose menaxheriale. Në vlerësimin e këtij nënkriteri, vlerësuesi (anëtari i Këshillit) orientohet duke

shqyrtuar nëse kandidati ka tituj akademikë, ka kryer studime afatgjata në programin e të cilave ka pasur lëndë të së drejtës penale ose lëndë në fushën e menaxhimit (psh studimet në Shkollën e Magjistraturës, një Master Shkencor ose studime të tjera afatgjata) etj.

Nënkriteri 1.5: Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit - (1 - 4 pikë)

Nënkriteri 1.5 shërben për të matur angazhimin profesional e shkencor të kandidatit gjatë 5 viteve të fundit. Në vlerësimin e këtij nënkriteri, vlerësuesi shqyrton sa më poshtë:

- (i) sasinë e kontributeve shkencore e profesionale të kandidatit;
- (ii) relevancën e kontributeve profesionale e shkencore të kandidatit me natyrën e punës dhe kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm;
- (iii) cilësinë e kontributeve duke u nisur nga rëndësia e forumit ku është dhënë kontributi (psh rëndësia e revistës ku është botuar artikulli, rëndësia e konferencës ku është mbajtur ligjërata, universiteti ku është mbrojtur doktoratura etj).

Kriteri 2: - deri në 4 pikë

Nënkriteret 2.1 & 2.2: Reputacioni Profesional dhe Reputacioni Shoqëror - (1 - 4 pikë)

Nënkriteret 2.2 dhe 2.3 shërbejnë për të matur reputacionin profesional e shoqëror të kandidatit gjatë 5 viteve të fundit. Në vlerësimin e këtij nënkriteri, vlerësuesi (anëtari i Këshillit) përpiqet të kuptojë nëse në të kaluarën kandidati i ka ushtruar funksionet e tij profesionale pa favorizim, nuk ka kërkuar avantazhe të pamërituara dhe ka zbatuar me korrektësi detyrat profesionale.

Në vlerësimin e këtij nënkriteri vlerësuesi nisët nga prezumimi se kandidatët gëzojnë reputacionin e nevojshëm profesional e shoqëror për të kryer detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Kandidatët do të vlerësohen me pikë nga 1 deri në 4 në varësi të saktësisë së përgjigjeve që do ti japin pyetjeve me natyrë etike që do t'iu bëhen gjatë intervistës me Këshillin.

Kriteri 3: - deri në 20 pikë

Nënkriteri 3.1: Aftësitë organizative dhe drejtuese - (1 - 5 pikë)

Nënkriteri 3.1 shërben për të matur aftësitë organizative e drejtuese të kandidatit të cilat do të jenë shumë të rëndësishme në punën e Prokurorit të

Përgjithshëm. Në vlerësimin e këtij nënkriteri, vlerësuesi do të përqëndrohet në shqyrtimin e 3 drejtimeve të më poshtëme:

- (i) qartësia dhe saktësia e platformës së paraqitur nga kandidati duke iu referuar edhe respektimit nga ana e kandidatit të formatit të platformës që gjendet në Aneksin A të Rregullores së Këshillit “Për Kriteret dhe Procedurat e Përzgjedhjes së Kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”;
- (ii) qartësia dhe saktësia e kandidatit në identifikimin dhe artikullimin e sfidave që paraqet ushtrimi i detyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe sistemi i prokurorisë në përgjithësi; dhe
- (iii) qartësia dhe saktësia e kandidatit në identifikimin dhe formulimin e ideve/planeve për adresimin e sfidave.

Nënkriteri 3.2: Aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve – (1 - 5 pikë)

Nënkriteri 3.2 shërben për të matur aftësitë vendimmarrëse e drejtuese të kandidatit të cilat do të jenë shumë të rëndësishme në punën e Prokurorit të Përgjithshëm. Në vlerësimin e këtij nënkriteri, vlerësuesi do të përqëndrohet në shqyrtimin e 3 drejtimeve të mëposhtëme:

- (i) Eksperiencat drejtuese e vendimmarrëse e kandidatit në të kaluarën;
- (ii) Niveli në të cilin kandidati i ka ushtruar kompetencat vendimmarrëse e drejtuese;
- (iii) Rezultatet e arritura në drejtim/menaxhim.

Nënkriteret 3.3 & 3.5: Aftësitë në komunikim dhe përfaqësim publik – (1 - 7 pikë)

Nënkriteret 3.3 dhe 3.5 shërbejnë për të matur aftësitë e kandidatit në komunikim dhe në përfaqësimin në publik të ideve, politikave dhe vendimeve. Në vlerësimin e këtij nënkriteri, vlerësuesi bazohet në dokumentacionin e depozituar nga kandidati ose të siguruar përmes letërkëmbimit me institucionet e tjera si dhe në prezantimin e kandidatit gjatë intervistës.

Fakte të cilat mund të konsiderohen relevante për vlerësimin e aftësive në komunikim dhe përfaqësim publik të kandidatit mund të jenë:

- (i) eksperiencat si trainer/lektor dhe forma të tjera të ligjërimit publik;
- (ii) eksperiencat si udhëheqës diplome, udhëheqës shkencor, udhëheqës në praktikën profesionale (ose forma të tjera të këshillimit/udhëheqjes);
- (iii) eksperiencat si folës ose moderator në konferenca dhe aktivitete të tjera të nivelit të lartë;
- (iv) eksperiencat si përfaqësues në gjyq i çështjeve me interes të lartë publik; dhe

(v) prezantimi i kandidatit gjatë intervistës etj.

Nënkriteri 3.4: Aftësia për të punuar në dhe në mjedise multidisiplinare dhe ose multikulturale - (1 - 3 pikë)

Nënkriteri 3.4 shërben për të matur aftësitë e kandidatit për të punuar në mjedise multidisiplinore dhe ose multikulturale. Në vlerësimin e këtij nënkriteri, vlerësuesi bazohet në dokumentacionin e depozituar nga kandidati ose të siguruar përmes letërkëmbimit me institucionet e tjera si dhe në prezantimin e kandidatit gjatë intervistës.

Fakte të cilat mund të konsiderohen relevante për vlerësimin e këtij nënkriteri përfshijnë eksperiencat e kandidatit si anëtar i grupeve të punës, eksperiencat si ekspert ose përfitues në projekte të asistencës ndërkombëtare, trainimet jashtë vendit etj.

Elementë shtesë për vlerësimin e kandidatëve (1 -6 pikë)

Anëtari i Këshillit orientohet në caktimin e pikëve për aftësitë në komunikim dhe përfaqësim publik duke iu referuar fakteve të tilla si: (i) pasja e titujve akademikë Profesor ose As. Profesor (ii) pasja e gradës "Doktor" vetëm për kandidatët magjistratë, (iii) kryerja e studimeve dhe trainimeve afatgjata jashtë vendit; (iv) dhe zotërimi i gjuhëve të huaja duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.

² Në varësi të sasisë së trainimeve, kohëzgjatjes dhe relevancës së tyre me natyrën e kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm.